

**Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut vetëm të Shoqërisë K-
Investments Group Ltd**

Sot, më 29 / 09 / 2023, ortaku i Shoqërisë **K-Investments Group Ltd (Shoqëria)**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe, e regjistruar në regjistrin tregtar më datë 29 mars 2022, me Nr.14009858, me seli në Britaninë e Madhe, Angli, 409-411 Croydon Road, Beckenham, BR3 3PP, u mbledh me qëllim arritjen e një vendimi si vijon.

Prezent ishte Ortakja:

- A. Brunilda Ibraj**, shtetase britanike, e bija e Selmanit, e datëlindjes 18.05.1975, lindur në Peshkopi dhe banuese në Angli, identifikuar me Pasaportën Nr. 530788751 (zotëruese i 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë).

Sa më sipër, u verifikua prezenca e ortakes së vetme të Shoqërisë dhe u sigurua se ishte prezent ortaku që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të kësaj Shoqërie.

Në këto kushte, u verifikua se oraktja pjesëmarrëse ka kuorumin e nevojshëm për arritjen e një vendimi sipas rendit të ditës.

Ortakja prezent, shqyrtoi mbi këto çështje sipas rendit të ditës:

1. Themelimi i një dege në Shqipëri të quajtur **K-Investments Group Degë e Shoqërisë së Huaj**, me seli në Tiranë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, me afat të pacaktuar.
2. Çdo çështje tjetër që lidhet me themelimin e Degës.

Pasi u diskutuan të gjithë pikat e rendit të ditës,

U VENDOS

1. Të krijohet dhe regjistrohet një degë në Republikën e Shqipërisë e quajtur **K-Investments Group Degë e Shoqërisë së Huaj**, me seli të regjistruar në Tiranë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, me afat të pacaktuar.
2. Dega do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj si më poshtë:
Shitblerja e pasurive të paluajtshme, dhënie me qira dhe administrim i pasurive të paluajtshme në pronësi ose me qira.

Brunilda Ibraj

3. Përfaqësuesi ligjor i degës do të jetë **z. Zaim Bardhi**, i biri i Sadriut, shtetas shqiptar, i datëlindjes 25/04/1977, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. 036901611 dhe Nr. Personal H704251830.

Përfaqësuesi ligjor ka tagrat për të kryer të gjitha aktivitetet e nevojshme për të rregjistruar Degën dhe për ta menaxhuar atë dhe gjithashtu ta përfaqësojë Degën në Shqipëri para palëve të treta, institucioneve ose enteve publike ose private; të lidhë kontrata në emër dhe për llogari të Degës me palë të treta; të ndryshojë selinë qendrore dhe ose zyrat e hapura ose njësitë vendore; të punësojë dhe pushojë nga puna punonjës ose personel të degës siç mund ta konsiderojë të nevojshme për aktivitetin e degës; të përfaqësojë Degën në Shqipëri përpara çdo Banke të Nivelit të Dytë dhe të kryejë të gjitha transaksionet bankare dhe financiare në emër të Degës; të kryejë çdo veprim tjetër ose aktivitet biznesi që konsiderohet i nevojshëm për veprimtarinë e Degës në Shqipëri.

Përfaqësuesi ligjor ka tagrat që të caktojë Avokatë tek të cilët mund të delegojë disa nga tagrat që ka bazuar në këtë vendim, për aq sa është e nevojshme për menaxhimin dhe mirëfunksionimin e Degës në Shqipëri.

4. Të autorizojë **Av. Soljan Celibashi** me nr. licence 2964, **Av. Beriola Karafili**, shtetase Shqiptare, me nr. licence 7577 si dhe **Av. Joana Lleshi**, me nr. licence 9274, që së bashku ose veçmas nga njëri tjetri, të kryejnë veprimet si më poshtë:

- Procedurën e depozitimit/regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), nëpërmjet platformës elektronike e-albania të dokumenteve të shoqërisë për themelimin e Degës në Shqipëri si dhe të gjitha vendimeve/kërkimeve të tjera në emër dhe për llogari të Degës.
- Procedurën e aplikimit/regjistrimit për t'u pajisur me nënshkrim elektronik e-sign, pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).
- Procedurën e aplikimit/regjistrimit të subjektit në Regjistrin e Pronarëve Përfitues pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Duke mos patur çështje të tjera për të diskutuar, ortakja e vetme e Shoqërisë miraton vendimarrjen e sipërcituar, të miratuar rregullisht sipas legjislacionit në fuqi.

Ortakja e vetme e Shoqërisë K-Intestments Group Ltd

Zj. Brunilda Ibraj BRUNILDA IBRAJ

Brunilda Ibraj
K. INVESTMENTS
GROUP LTD
NR. 14009858